

BARDHYL DEMIRAJ

NUMËRORI KATËR NË GJUHËN SHQIPE NË VËSHTRIMIN HISTORIK

1. Numërori «katër» për gjuhën bazë indoевropiane rindërtohet përgjithësisht si njësi e optimit atematik më lëngëtoren /-r/ në numrin shumës¹: m. */quetuor-es/, f. */quetesr-es/, as./quetuōr/. Ndërsa format e rindërtuara, gjininë femërore origjinare e dëshmojnë vetëm dega aria-ne dhe kelte: ind. e vj. m. *catvārah*, f. *cátastrah*, as. *catvāri*; avest. m. *čātvārō*, f. *čatanrō*; pers. e re *čahār* etj. Gjetkë ndeshen dy forma: gr. *tetraqs*, -qa sll. vj. kish. m. *četyre*, f. (as.) *četyri* etj.; lit. m. *keturi*, f. *keturios* etj.; ose vetëm një formë: got. *fidiōr*, lat. *quattuor* etj.

Gjatë trajtimit të këtij numërori në plan indoevropian është vënë në dukje gjithashtu larmia e formave ablautive (apofonike) që paraqet kjo njësi gjatë paradigmës së saj (:Em. **quetuor-es*, kall. **quetur-ns*, gjin. **quetur-ōm*, rrj. **quetur-su*). Zhvillimet ablautive të kësaj temë kanë bërë që ajo t'u nënshtrohet, qysh në gjuhën bazë, dukurive të ndryshme fonologjike², të cilat janë thelluar edhe më tej gjatë evolucionit të paravarur në gjuhët e veçanta indoevropiane. Kjo gjë ka sjellë në shumë raste, ndërlimin e lidhjeve etimologjike me format e rindërtuara për gjuhën bazë indoevropiane.

2. E tillë paraqitet gjendja edhe për numërorin *katër* në gjuhën shqipe, të cilin e kemi bërë edhe objekt të kësaj trajtese.

2.1. Në të folmet e dialekteve të shqipes dhe të diasporës si edhe te autorët tanë më të vjetër, numërori në shqyrtim paraqitet me një formë të ngurosur: /*katər*/, të njëjtë me gjegjësen e normëzuar në gjuhën e sotme letrare³:

Tek Buzuku: ... e gjithë shtansë n katër kambësh. (LIX f. 227)
... nd atë të madh e të naltë gûr n katër kodrësh⁴ (LXXXI, f. 351).

1) Shih për këtë, ndërsa tjetër, K. Brugmann, *Grundriss*, II, 2, f. 12; O. Szemerényi, *Einführung in die Vergleichende Sprachwissenschaft*, Darmstadt, 1980, f. 206; J. Pokorny, IEW, I, f. 642 v.

2) Kështu, vërehet, ndërsa tjetra, zhvillimi i metatezës në grupin */u/ + */R/ → → */Ru/ në pozicion fundor ose para një bashkëtingëllorreje: **quetur* (—) → → **quetu*(—): ar. čātru, gal. petru etj. Shih M. Mayrhofer, *Indogermanische Grammatik*, I-1/2, Heidelberg, 1986, f. 161.

3) Shih *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare, shqipe*, II, 1976, f. 168 v.

4) Tek Buzuku ky numëror herë-herë, merr si rezultat i zhvillimeve të ndryshme analogjike, edhe shenjuesin e rasës gjinore shumës: *Gjoni pae për vjednis shkambit të katërave shtansëve* (LXXX, f. 345); ... tē madh zā t'katërve engjëj LXXX, f. 347) etj.

Si zhvillim analogjik do të vërejmë edhe -ë-në fundore tek forma (*katărë*) që del herë-herë tek ky autor edhe tek Bardhi... për katërë muoj (LIII, f. 163); ... e gjet sa ish ndë varr qysh katărë dit (LXIII, f. 183).

Tek Budi: *Praashtu ndr ato tē katēr anëtē e shekullit* (DC 86, 5); ... *Këto tē katēr pjesëtē...* (DC 93, 16); ... *e katēr tē tjeratē janë ato,* ... (DC, 94, 8).

Tek Bardhi: *N katēr dhambësh* «quadridens», *Për katēr viet «quadrinium»; Barka n katēr remash* «quadriremis» etj.

Teg Bodani: *Katter janë ma tē madhejtë* (Skal I, Ligj V, f. 66); *Aso së katēr vertytesh* (Skal I, Ligj V, f. 68).

Tek Matrënga: *Tē katēr urëtē... Katēr, besë, pandohi tē dashurë e tē bëëme tē mirë* (Drsh 1, f. 10).

2.2. Struktura fonologjike /katər/, që përcaktohet si e tillë pér një periudhë historike tē gjuhës deri para Buzukut (shek. XVI etj.)⁵, i ka errësuar lidhjet e drejtpërdrejta etimologjike me formën e rindërtuar pér gjuhën bazë indoevropiane */quétuor-/. Vështirësia më e madhe qëndron në trajtimin diakronik tē rrokjes nistore *que- në tē cilin tektalja labiovelare /qu/ në pozicion para zanores së përparme /e/ pritej tē shndërrrohej në /s/ pér shqipen: khs. *pesë* < *penque, *dasëm*, *dars-më* < *darqueimā⁶ etj.

Kjo mospërputhje e rezultateve tē analizës fonologjike pér njësinë në shqyrtim, ka sjellë péshtjellime edhe në zgjidhjen etimologjike tē saj. Ndër mendimet e parashtruara deri më sot bëhen dy grupime tē mëdha:

2.2.1. Studiues tē ndryshém tē shekullit tē kaluar e tē fillimit tē shekullit tonë, si A. Poti, G. Majeri, K. Brugmani, H. Pederseni etj., duke parë pamundësinë e motivimit me mjetet e shqipes tē rrokjes nistore *ka(tēr)*, janë shprehur pér një huazim latin në shqipen, ose, në rastin më tē mirë, pér një riformim tē strukturës fonologjike burimore tē shqipes nëpërmjet gjegjëses latine *quattuor*, lat. vulg. *quattor*⁷.

2.2.2. Studiues tē tjerë tē shekullit tonë si H. Gynterti, N. Jokli, H. Bariçi, S. Mani, M. La Piana, E. Çabej, etj. janë shprehur kundër ndikimit latin⁸. Pér ta motivuar këtë, ata janë mbështetur kryesisht në një faktor gjuhësor tē jashtëm, në karakterin autokton tē numërorëve tē vegjël një... dhjetë në gjuhën shqipe.

3. Nga sa shihet, trajtimi diakronik i këtij numërori në shqipe sillet më fort rrëth raportit *trashëgim* — *huazim*. Zgjidhja e tij në tē mirë tē

- 5) Në ndonjë tē folme tē toskërishtes jugore (Çamëri) dhe tē diasporës (Salaminë; Falkonora, San Marcano) dëshmohet varianti formativ /katrə/. Kjo shpjegohet me riformimin në këto tē folme tē gjithë tipit strukturor, në tē cilin grupohet kjo njësi: *motrë, dhëndrë, èndrë* etj.
- 6) Shih H. Pedersen, *KZ*, 36, 1900, f. 307v.; E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, Fonetika historike e shqipes*, Tirana, 1961, f. 110.
- 7) Shih A. Pott, *Die Sprachverschiedenheit in Europa*, Halle, 1868, f. 17; G. Meyer, AS, II, f. 45v.; EWA, f. 181; K. Brugmann, *vep. cit.*, f. 13; H. Pedersen në «Philologica» II, f. 169; W. Meyer-Lübke, *Gröbers Grundriss* I², f. 1041 etj.
- 8) Shih H. Güntert, *Indogermanische Ablautprobleme*, Strassburg, 1916, f. 91v.; N. Jokli, SF, 3, 1967, f. 124; H. Bariç, *Hymje në historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1955, f. 10; S. Mann, *Language* 17, f. 379 v.; M. La Piana *Studi lingüistici albanesi*, I, Palermo, 1939, f. 84; E. Çabej, *Studime etimologjike* (fjala *katēr*, e pabotuar) etj. Pér karakterin autokton éshtë shprehur fillimisht edhe G. Meyer në B,B, 8, 1884, f. 185 v.

trashëgimit ndërthuret me çështje të tjera të karakterit fonologjik, që përcaktojnë rrugën e tij evolutive në gjuhën shqipe.

3.1. Po të marrim në vështrim faktorin gjuhësor të jashtëm, gjejmë më të mbështetur tezën e grupit të dytë të gjuhëtarëve. Një ndikim latin mbi shqipen del si diçka «*e papritur*» në radhën e njësheve *një... dhjetë*.

3.2. Shqyrtimi i faktorëve gjuhësorë të brendshëm — rruga evo-lutive e strukturës fonologjike të numërorit në shqyrtim nuk do ta kundërshtonte një ndikim të mundshëm latin (lat. *vulg. quattor*). Në këtë rast, rrokja e theksuar lat. /qua-/ do të zhvillohej në shqipen /ka/, siku se te *kartë* «masë drithi» < lat. *quarta*⁹. Kurse rrokja e patheksuar, lat. /-ttor/ mund të zhvillohej në shqipe edhe /-tər/.

3.3. Për sa i përket vijimit të studimit në planin fonologjik, vërejmë se të dyja format, lat. *quattuor*, shq. *katër* parashtrojnë njëlloj probleme kundrejt formës së rindërtuar për gjuhën bazë indoevropiane **quetuor*. Ashtu si në shqipe (§ 2.2) edhe në latinishtë zanorja e theksuar /a/ nuk mund të shpjegohet dot nga i.e.* /e/.

Megjithatë, në latinishtë kjo shmangje në zanoren e parë të temës është arritur të shpjegohet. Sipas mendimit të përgjithshëm, burimi i fonemës /a/ te *quattuor* lidhet me një mbeturinë zanore të indoevropiane **quetuor*, që njihet tashmë me termin *zanore e reduktuar* ose «Schwa secundum» (shva sekundum) e që dëshmohet në një numër fjalësh si *patere* «qëndroj hapur», *pandere* «shtrij», *carpo* «pres»; *caro* «i dashur» etj.¹¹

3.3.1. Duke dashur të hapim një parantezë, që lidhet drejtpërsëdrejti me trajtesën tonë, shënojmë se e ashtuquajtura shva sekundum, zanore e reduktuar **e*, përcaktohet sot si një element zanor që shfaqet herë pas here në shkallën zero të ablautit kuantitativ indoevropian si vijim i zanores ablautive në pozicion ndërmjet dy bashkëtingëllorësh (kryesisht mbylltore)¹². Kjo mbeturinë zanore në gjuhët e veçanta i.e. ose është bjerrë, ose ka zhvilluar një timbër të caktuar zanor që saktësohet për gr. /i/; lat. /a/, gjerm. /u/, sll. vj. /þ/ etj.¹³

Në qerthullin e shembujve më të sigurtë që argumentojnë bindshëm praninë në gjuhën bazë të kësaj mbeturine zanore, është padyshim numërori «katër». Në rrokjen nistore të këtij numërori, krahas ndërrimeve të shpeshta ablautive **quet-* **qut-* (§1) janë vëzhguar përgjithësisht përmes kësaj mbeturinë zanore, që është një variant i *quæt-*. Madje, edhe për numërorin themelor, ku rrokja nistore në përgjithësi është në shkallën ablautive normale **quet-* qëmtohen

9) Shih E. Çabej, *Studime etimologjike*, I, Tiranë, 1982, f. 269; H. Haarmann, *Der lateinische Lehnwortschatz im Albanischen*, Hamburg, 1972, f. 144.

10) Shih për zhvillimin e ie. */e/ në latinishtë F. Sommer, *Handbuch der lateinischen Sprache*, 1914, f. 36, 466 v.

11) Shih ndër të tjerë H. Güntert, *vep. cit.*, f. 45 v.; F. Sommer, *vep. cit.*, f. 54 v. etj.

12) Zanorja e reduktuar e shkallës ablautive zero * u emërtua në fillim të shkallit tonë si *Schwa secundum* në dallim nga *Schwa primum*, *Schwa indogermanicum*, zanoret e murmurta ose laringalet, siç quhen sot në indoevropianistikë. Shih H. Güntert, *vep. cit.*, f. 41 v.

13) Shih J. Gippert, *Acta Orientalia*, 40, 1979, f. 273.

raste të një errësimi *qu_et- brenda paradigmës; krhs. lat. *quattuor*, gr. homeri. πεντε; ; çek čtyri, pol. czetery (*čtyr- ~ sll. e vj. četyre).

3.4. Në vijim të tezës së vet mbi trashëgiminë indoevropiane të numërorit *katér* në gjuhën shqipe, H. Gynterti, e pas tij N. Jokli dhe H. Bariçi, janë përpjekur të vendosin lidhje etimologjike midis fonemës /a/ të rrokjes së parë me i.e. *¹⁴. Veçse do vënë në dukje këtu që shqyrtimi i kësaj dukurie në shqipe ka mbetur ende i pastudiuar. Ai është kufizuar vetëm për numërorin *katér* e për ndonjë njësi tjetër (§ 4.1).

4. Siç del edhe nga ky parashtrim i përbledhur i faktorëve gjuhësorë të jashtëm dhe të brendshëm, marrëdhëniet e ngushta që vendosin shq. *katér* dhe lat. *quattuor* me njëra-tjetërën dhe me formën e rindërtuar për gjuhën bazë indoevropiane **quetuor-*, e ndërlidhjnë edhe më shumë zgjidhjen e raportit *trashëgim* ~ *huazim* për numërorin e shqipës. Në këto rrethana gjejmë më të mbështetur mendimin që e kundron këtë raport në lidhje të ngushtë me fatin e mbeturinës zanore shva sekundum në gjuhën shqipe.

Nga analiza fonologjike e materialit faktik të trajtuar ose jo gjër më sot nga ky këndvështrim, kemi mundur të veçojmë disa njësi, në strukturën fonologjike të të cilave rezulton vijimi i mbeturinës zanore i.e. *¹⁵ në shqipen /a/.

4.1. Fjala *thadér* f. «lloj sqepari i ngushtë e me dy presa, njëra si çdo sqepar e tjera si daltë». N. Jokli e më pas H. Bariçi (shën. 8) kanë vënë re tek kjo fjale një tjetër rast analog (krahas *katér*) të reflektimit të i.e. *¹⁶ > shq. /a/.

Përgjithësisht pranohet sot për shqipen një paraformë e rindërtuar **k_es* — *d^hro-m* që krahasohet me formën tjetër **k_es* (*k_es*-*tro-m* e cila rindërtohet për lat. *castro* «pres, tredh», *castrum* «copë tokë e veçuar», ind. e vj. *śastrám* «thikë»¹⁵. Tek kjo formë e rindërtuar, pjesa e parë **k_es* (*k_es*-) është rrënja follore për «ther, pres, caj», që del në ind. e vj. *sásati*, *śásti* «pres, ther», gr. κείω κέαζω «çaj», sll. vj. *kosa* f. «drapër, kosë»¹⁶. Me këtë rrënje lidhet pandërmjetshëm edhe shq. *thej* (*thiej*, *kosëj*), me rrjedhojat e saj të hershme: *kthej*, *mbérthej*, *shpérthej*, *pérthej*, zanorja rrëniore e së cilës vijon shkallën normale të ablautit kuantitativ indoevropian¹⁷.

Për sa i përket pjesës së dytë *-d^hro-, ajo përfaqëson një formant emëror indoevropian, që përdoret ndër të tjera, edhe në emrat e veglave¹⁸. Karakteristikë e këtij formanti është se ai ndërndërrohet shpesh me formantet funksionalisht të ngjashëm *-tro-, -ro-¹⁹ që dalin tek njësitë latine dhe sanskrite, të marra në shqyrtim më sipër²⁰.

14) Shih për këta gjuhëtarë literaturën e cituar në shën. 8. M. La Piana në vep. cit. f. 84, e shpjegon shq. *katér* si refleks i rregullt i i.e. */*cuetuor-es/* ndërsa E. Çabej e lë të pashpjeguar zanoren /a/ tek kjo njësi.

15) Shih Ernout-Meillet, *DELL*, f. 104; E. Boisacq, *DELG*, f. 424; J. Pokorny, *IEW*, f. 586; E. Çabej, *Studime gjuhësore*, II, f. 199 etj. I fundit hedh edhe mendimin për një postverbal **thar*.

16) Shih P. Pokorny, *IEW*, I, f. 586.

17) Shih për gjurmët e ablautit kuantitativ indoevropian në shqipe G. Meyer, *IF*, V, 1893, f. 180 v.; E. Çabej, *Hyrje...*, f. 105.

18) Shih N. Jokli në vendin e cituar; E. Çabej, *Studime gjuhësore*, II, f. 199.

Sic del edhe nga interpretimi etimologjik i kësaj fjale, motivimi i zanores /a/ të shqipes *thadér*, nëpërmjet ie. *_e éshtë bindës. Formanti i.e. *-d^bro- duke mbartur theksin e fjalës mbi vete, ka shkaktuar reduktimin e zanores ablautive /e/ të rrënjos së fjalës *kes- (> shq. *thej*). Ndërsa kushtet fonetike të krijuara nuk kanë lejuar një bjerrje të plotë të saj. Ky përfundim lidhet kryesisht me vështirësitetë në shqiptim të një grupi prej katër bashkëtingëllorësh si edhe me prirjen për të ruajtur të qartë kufijtë rrënjos nga zhvillimet e mëtejshme fonologjike²¹.

4.2. Mbiemri i *madh* «për diçka me përmasa dhe vëllim mbi mesatoren». Përgjithësisht pranohet sot karakteri i trashëguar indoevropian i kësaj fjale në shqipe. Që nga Bopi e këtej²², ajo éshtë sjellë për krahasim me gjegjëset ind. e vj. *mah*; av. *maz*; arm. *mec*; gr. μέγας, μέγιστη, irl. e mesme *mag* etj., për të cilat rindërtohet një formë bazë */meg-/ e ep-timit tematik²³.

Ndryshe nga këto gjuhë, lat. *magnus* «i madh» éshtë përfthuar në-përmjet shtimit të formantit *-no-, i cili, duke mbartur theksin mbi vete ka shkaktuar errësimin e zanores ablautive të rrënjos: */m_eg'-no-s/. Po kështu shkalla krahasore *maior* «më i madh» nga një */m_eg'-iōs-/²⁴. Shmangje nga tipi i përgjithshëm dëshmohet edhe për ind. e vj. *mahāh* «i madh», e përfthuar nga tematizimi i fortë */meg'oh₂-/²⁵.

Në këtë mëdis krahasues edhe shq. (*i*) *madh* zë një pozicion të veçantë, që e largon disi nga tipi i përgjithshëm ie. **meg'*. Edhe këtu ndeshet vështirësia e trajtimit diakronik të zanores /a/, e cila nuk mund të afrohet në përqasje me zanoren ablautive të rrënjos */e/. Një zhvillim fonologjik normal i saj në shqipe, në këtë mëdis fonetik, nuk do të mund t'i shpëtonte diftongimit²⁶: *djeg*, *pjek*, *rrjep*, *mjegull*, *vjedhull*, *miell*, *mjel* etj. Gjithashtu kjo zanore vështirë se éshtë përfthuar nga një vokalizim */o/ i ablautit kualitativ të rrënjos origjinare **meg'*, apo nga një /a/ e dikurshme.

Nga ana tjetër, edhe në qoftë se do të merret në analizë forma e rindërtuar ie. **meg'*, vështirë se mund të motivohet një errësim i zanores rrëniore */e/, e cila thuajse gjatë gjithë paradigmës qëndron në pozicion të theksuar²⁷. Në këto rrëthana mund të supozohet që në zanafillë shq. *madh* lidhet me shkallën krahasore **m_eg'-iōs*, e cila, sikurse në lat. *maior*, ka errësuar në pozicion jashtë theksit zanoren rrëniore: **m_eg'(-iōs)*.

19) Shih K. Brugmann, *Grundriss*, I, 2, f. 324.

20) Deaspirimi i dentales ie. */d^b/ → shq /d/ motivohet plotësisht në pozicion para likuidës /r/. Shih për zhvillimet e dentaleve në kushtet e fonetikës sintaksore për gjuhën shqipe W. Cimochowski, «Lingua Posnaniensis», 2, 1950, f. 227.

21) Mundësia e motivimit të zanores /a/ të rrënjos së fjalës me anën e vokalizmit ablautiv kualitativ */o/ ose nga një ie. */a/ duhet të lihet jashtë vështrimit, përderisa nuk gjen mbështetje në asnje nga gjuhët me dokumentim të herëshëm. Shih. J. Pokorny, *IEW*, I, f. 586.

22) Shih Fr. Bopp, *Über das Albanesische in seinen verwandschaftlichen Beziehungen*, 1954, f. 511; G. Meyer, *EWA*, f. 252, AS III, f. 18; Boisacq, *DELG*, f. 617 v.

23) Shih J. Pokorny, *IEW*, I, f. 708; M. Mayrhofer, *vep. cit.*, f. 136, 176.

24) Shih Ernout-Meillet, *DELL*, f. 379.

25) Shih për këtë së bashku me literaturën përkatëse, M. Mayrhofer, në vendin e cituar.

26) Shih për zhvillimin e ie. */e/ në shqipe G. Meyer, AS, III, f. 83; E. Çabej, *Hyrje...*, f. 94.

27) Për paradigmën e temave nominale shih O. Szemerényi, *vep. cit.*, f. 148, 167v.

4.3. Emri *shpat* «Faqe e pjerrët e një malit a e një kodre, zakonisht e gjerë dhe pa gropë». Me këtë kuptim përdoret sot kryesisht në dialektin geg, ku del edhe në toponimi. Në dialekthin tosk dhe në të folmet e diasporës përdoret sot me derivacionin semantik «pyll në faqe të një malit», ndërsa kuptimi i parë është zëvendësuar me sinonimet: *breg*, *brijnjë*, *faqe* etj.²⁸

Këtë fjalë N. Jokli e ka zërberthyer me *sh-pat* dhe rrënjen e fjalës *-pat* e krahason me gr. πετής, në ποπτετής, «që bie kryengulthi, që priret përparrë», πάτω «bie»; ind. e vj. *pátati* «fluturon, ulet, bie». Brenda shqipes ai e krahason atë me *shpend*, *shpes*²⁹.

Po brenda shqipes, kjo fjalë duhet të lidhet etimologjikisht me leksemën *pjetë* te *përpjetë* ndajfolje dhe parafjalë që shënon «drejtimin nga lart, termal, lart», në arbërishten e Italisë *pjeti-poshtë* «lart e poshtë», anton. *tatëpjetë* «poshtë». Edhe për këtë njësi është vënë në dukje afëria me ind. e vj. *pátati*, gr. ποπτετής; lat. *peto*. etj.³⁰

Pas gjithë gjasash (*sh*) *pat*³¹, *-pjetë*, (*sh*)*pend*³² përfaqësojnë në shqipe një çerdhe leksikore të përfshuar nga baza i.e /pét-/; *pt-/ «bie mbi diçka kryengulthi, fluturon ulet».

28) Shih për kuptimet dhe përhapjen dialektore të kësaj fjale. E. Çabej, *Studime gjuhësore*, II, Prishtinë, 1976, f. 146; *Fjalori i «Bashkimit»*, f. 432; *Fjalor i ar-bëreshëve të Italisë*, Bari, 1963, f. 474 *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, f. 198.

29) Shih N. Jokli, *LKU*, f. 163.

30) Shih D. Camarda, *Saggio di grammatica comparata sulla lingua albanese*, Livorno, 1864, f. 304; G. Meyer, *EWA*, f. 333; E. Çabej, SF, 3, 1979, f. 34 dhe *Studime gjuhësore*, II, f. 30. Shih tek ky i fundit edhe zhvillimet e ndryshme semantike e gramatikore të leksemës në shqyrtim në gjuhën shqipe: emër (*pjeti*, *pér-pjetë*); folje (*pjetem*).

31) E. Çabej, në vendet e cituara vëren te *shpat* një formim retrogrand nga lat. *spatula* në përdorimin e figurshëm *shpatull malit*. Në të mirë të këtij mendimi autorë sjell edhe togfjalëshin *shpatull malit*, që përdoret sot në ndonjë të folme të dialektit tosk.

Do vënë në dukje këtu se parametrat semantikë dhe fjalëformues të dy njësive më shumë i largojnë se sa i afrojnë këto njësi me njëra-tjetrën. Kështu, duhen mbajtur parasysh, ndër të tjera:

- a) Në shqipe nuk janë karakteristike formime retrogrande të këtij tipi.
- b) Njësia *shpatull* (< lat. *spatula*) me këtë veshje fonetike dhe me gjerësinë e vet semantike është fjalë e gjithmbarshme e shqipes dhe ka formuar edhe e vet leksikore e semantike; *shpatullan* -ar, -or, -inë etj. (Shih çerdhen e vet leksikore e semantike; *shpatullan* -ar, -or, -inë etj. (Shih FGjSSh, f. 1891). Me kuptimin «*shpat*, faqe e gjerë dhe e gjatë e një malit» përdoret në kuptim të tejbartur vetëm në disa zona të toskërishtes jugore, madje edhe këtu është e kufizuar në togfjalëshin: *shpatull malit*.

Ndryshe nga kjo fjalë, njësia *shpat*, si e gjithmbarshme e shqipes e me çerdhen e saj leksikore (*shpatinë*, *shpatore*) ka krijuar poliseminë e vet. Si përbërës origjinari semantik, siç do ta shohim edhe poshtë, është a) lartësia, përrësia nga poshtë-lart dhe anasjelltas e faqes së një malit a kodre. Ky përrësia del edhe sot në funksion predikativ: shemb. *tokë shpat* «pjerrësi»; bërsë del edhe sot në frazeologjizmat: *ia ngjiti pér shpat* «foli kot», *ia dha shpatit* «kaloi situatën» etj. Që këtej me zgjerim kuptimi kjo njësi ka zhvilluar diapazonin semantik në b) Faqe e pjerrët e një malit e kodre: *Shpate me pjerrësi të vogël*, *Shpate të rrëpirta* etj. E më vonë janë zhvilluar c) pyll në faqen e një malit dhe d) Drurë, hunj rrëthimi pér oborr dhe shpet (Të gjithë shembujt dhe kuptimet e fjalës janë nxjerrë nga kartoteka e leksikut në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë).

32) Shih J. Pokorny, *IEW*, I, f. 825; Ernout-Meillet, *PELL*, f. 503; Boisacq, *DELG*, f. 776, 787; M. Mayrhofer, *KEWA*, II, f. 199.

Në këtë çerdhe leksikore (*:sh-pat*, *-pjetë*, *sh-pend*) rindërtohet si përbërës semantik parësor ideja e ngjitjes (e fluturimit) nga poshtë-lartë dhe anasjelltas, e zbritjes nga lart-poshtë.

Në këndvështrimin morfonologjik, morfemat, *pjetë* dhe *shpend* paraqiten si vijim i pandërmjetshëm i bazës ie. */pet-/ në shkallë ablautive normale të zanores së rrënjos. ie. */e/ → shq. /je/; /e/³³. Nga ana tjetër, *-pat* shpjegohet vetëm si alomorf i kësaj baze. E si e tillë, zanafilla e fonemës zanore, të rrënjos do kërkuar në njërin nga variantet ablautive të saj. Duke qenë se për këtë rrënjos në gjuhët e ndryshme indoevropiane është karakteristik ndërndërrimi i shkallës nominale të zanores */e/ me shkallën ablautive zero (=Ø) të saj, atëherë ka shumë gjasë që (*sh*)*pat* të jetë vijim i variantit indoevropian */pt-/ të realizuar si /p_et/ me mbeturinën zanore shva sekundum³⁴.

5. Siç del edhe nga këta shembuj që u morën në shqyrtim, vokalizmit /a/ në gjuhën shqipe, ka shumë gjasë, që t'i shtohet edhe një burim tjetër i trashëguar nga gjuha bazë ie.; e pikërisht nga zanorja e reduktuar ie. *_e. Natyrisht, një zgjidhje përfundimtare e këtij problemi kaq të vështirë për gjuhën shqipe kërkon një studim të posaçëm dhe ballësor, i cili lidhet drejtpërsëdrejti me shtjellimin e dukurisë së ablautit indoevropian në shqipe.

Gjithsesi, shqyrtimi diakronik i shembuve të mësipërm, e tumir vëzhgimin e mprehtë të H. Gynterit, i cili vëren tek fonema /a/ e shq. *katër* vijimin e rregullt të zanores së reduktuar indoevropiane shva sekundum.

6. Kjo zgjidhje parashtron edhe nevojën e përcaktimit të rrugës evolutive që ka përshkuar struktura fonologjike dhe gramatikore e njësisë në shqyrtim që nga fazat e hershme të periudhës indoevropiane deri në shqipen e kohës së Buzukut.

6.1. Lidhur me strukturën fonologjike /katər/, çështja paraqitet deri diku e sqaruar tashmë për rrrokjen nistore. Në shqipe është plotësisht i mundshëm delabializimi i tektales ie. */qu/ para një vokalizmi me timbër drejt /a/-së³⁵. Kjo i vjen për shtat edhe zhvillimit të rregullt të shqipes: ie. */qu/ → shq. /k/ — /a/ (/*o*/, /*u*/)³⁶.

6.2. Nga ana tjetër, prania e zanores së reduktuar ie. *_e (→ shq. /a/) parakupton për rrrokjen nistore pozicionin e saj, në zanafillë, jashtë theksit, sikurse vërtetohet fillimi i edhe për gjuhët e tjera ie., si lat. *quattuor*, gr. πέντε sll. e vj. čëtyri.

6.3. Edhe rrrokja e dytë -tër shpjegohet pandërmjetshëm nga ie.

33) Shih për këto zhvillime fonologjike dhe kushtet e përfimit të tyre G. Meyer, AS III, f. 83 v.; E. Çabej, *Hyrje...*, f. 84.

34) Shih J. Pokorny, IEW, I, f. 824.

35) Në fazën e sotme të studimit të kësaj dukurie paraqitet tepër e vështirë vendosja e një raporti kronologjik midis delabializimit ie. /qu/ → shq. /k/ dhe vokalizimit të ie. *_e → shq. /a/. Ky i fundit duket të jetë më i hershëm.

36) Shih H. Pedersen, KZ, 36, 1900, f. 340; E. Çabej, *Hyrje...*, f. 110.

-tuōr-. Në këtë mjedis fonologjik nuk paraqet problem të veçantë bjerrja e gjysmëzanores */u/ → shq. Ø: krhs. shq. derē < ie. *d^buōr; degë < ie. *duoi-g^bā etj.³⁷

6.4. Ndërsa errësimi ie. */ō/ → shq. /ə/ shpjegohet me rivendosjen e mëvonshme të theksit të fjalës mbi rrrokjen nistore: /katər/ në përputhje të plotë me prirjen e vërtetuar në shqipe për theksimin e temave nominale në rrrokjen e parafundit³⁸.

Ndërkaq, mbetet i vështirë për shqipen përcaktimi i gjatësisë origjinare të fonemës */o/ (→ shq. /ə/) për këtë njësi. Kjo vështirësi vjen edhe nga që gjatësia e fonemës */o/ është e përligjur në zanafilë për gjininë asnjanëse */quetuōr/ (< */quetuorH/), por në disa gjuhë ka kaluar edhe për gjininë māshkullore, duke u përgjithësuar si formë-tip: */quetuōr-es/ > ind. e vj. *catvārah*, got. *fidoor* (< *feduōres), sll. e vj. četyre, ku /y/ < */ū/³⁹.

6.5. Me pozicionin në zanafilë jashtë theksit shpjegohet së fundi edhe bjerrja qysh herët e shenjuesve rasorë të rasave em. kall. shumës */-es/, */-ns/ të gjinisë mashkullore dhe */H/ e gjinisë asnjanëse⁴⁰. Duhet të shtojmë këtu edhe përgjithësimin e hershëm të formave të palakuveshme në sistemin e numërove të shqipes.

7. Analiza e strukturës morfollogjike të njësisë në shqyrtim përcaktton grupimin tipologjik të saj brenda sistemit emëror të gjuhës shqipe. Gjithashtu ajo ndihmon edhe në shtjellimin e ndonjë çështjeje të karakterit fonologjik që lidhet me trajtimin e fundores së temave ie. në lëngëtore në gjuhën shqipe.

7.1. Në planin strukturor-tipologjik njësia /katər/ grupohet me temat e trashëguara në lëngëtoren /-r/ të tipit *motēr*, *vjehēr(r)*, *dhēndēr* etj.⁴¹. Strukturimi i saj në këtë formë-tip duket të jetë përfunduar në periudhën pas zhvendosjes së theksit në rrrokjen nistore (§ 6.4) dhe bjerrjes së shenjuesve rasorë të shumësít tek kjo njësi (§ 6.5).

Në këtë tip strukturor, fundorja tematike /-r/ del e mirëruajtur, ashtu si në të gjitha temat nominale të fondit autokton të gjuhës shqipe që dalin më /-r/: *bar*, *gomar*, *njer*, *bir*, *gur* etj., si edhe huazimet nga latinishtja: *ar*, *par*, *mullar*, *sherr* etj., greqishtja: *kandar*, *piper*, *margaritar* etj., sllavishtja: *oborr* etj.⁴².

7.2. Arsyet e ruajtjes së këtij statusi fonologjik në temat dyrrokëshe të trashëguara më -r, për rrjetdhojë edhe tek *katēr*, mbeten sot për sot tepër të vështira për të hulumtuar në mënyrë shteruese.

37) Shih G. Meyer, AS III, f. 39.

38) Shih për këtë dukuri edhe mendimet e N. Joklit, E. Çabejt, etj. së bashku me literaturën përkatëse; Sh. Demiraj, *Gramatika historike e shqipes*, Tiranë, 1986, f. 63 v.

39) Shih O. Szemerényi, *vep. cit.*, f. 205.

40) Shih për shenjuesit rasorë në gjuhën bazë ie. O. Szemenéyi, *vep. cit.*, f. 146. Simboli /H/ është shenjues i disa fonemave të rindërtuara për gjuhën bazë e që përdoren me termin «laringale» (*h₁*, *h₂*, *h₃*).

Për bjerrjen e shenjuesve rasorë në shqipe shih M. Domi, *Morfologjia historike e shqipes*, Tiranë, 1961, f. 14 v.; Sh. Demiraj, *vep. cit.*, f. 253.

41) Shih për karakteristikat e këtij tipi strukturor dhe për zhvillimin e tij në shqipe, B. Bokshi, «Gjurmime albanologjike», I, 1971, f. 29 v.

42) Shih G. Meyer, AS I, f. 311 v.

7.3. Në planin historik-krahasues të jashtëm, ruajtja e fundores tematike (-r) shpjegohet në mënyrë bindëse me gjatësinë e zanores së pathekssuar të rrokjes fundore, e cila, në rasën emërore, vërtetohet përgjithësisht në shkallën ablautive të zgjeruar */-ë/⁴³; krhs, gr. homer. μήτηρ lat. mater etj.⁴⁴. E në këtë tip strukturor të përcaktuar për gjuhën bazë ie. grupohet tashmë edhe tipi strukturor morfollogjik i shqipes me model njësitë e trashëguara motër, dhëndër(r), vjehër(r).

8. Në këto rrethana, kundrimi i shq. /katr/ brenda tipit strukturor-morfologjik në shqyrtim na lejon të vendosim ura lidhëse etimologjike me njëren nga format e rindërtuara për gjuhën bazë indoevropiane.

Kështu duke marrë parasysh gjithë sa u kumtua më sipër, rindërtojmë si formë bazë parashqiptare*/qu_etuōr(-es)/, e cila nëpërmjet një forme ndërmjetëse */kater/ ka përfunduar në shqipen e periudhës së Buzukut katër, ashtu siç paraqitet edhe sot e normëzuar në gjuhën letrare kombëtare.

Zusammenfassung

DIACHRONISCHE UNTERSUCHUNG DES ZAHLWORTES KATËR «4» IM ALBANISCHEN

(«Schwa secundum» im Albanischen)

Das Schicksal der diachronischen Untersuchung des Zahlwortes *katër* «vier» im Albanischen ist stets in engem Zusammenhang mit dem Ursprung des Vokalismus /a/ der ersten Silbe gesehen worden, wofür die verschiedenen Sprachforscher zwei mögliche Auswege in Betracht gezogen haben. Entweder bleibt es von der albanischen gesetzhaften Sprachregeln unerklärt, indem man alb. *katër* auf einer lateinischen Entlehnung *quattuor*, vulg. lat. *quattor* zurückgehen lässt (A. Pott, G. Meyer, K. Brugmann, H. Pedersen usw.), oder aber folgt es ursprünglich dem reduzierten Vokal Schwa Secundum *_e unmittelbar nach (H. Güntert, N. Jokl usw.), welcher zu einer rekonstruierten Formvariante idg. */qu_etuōr(-es)/ gehört.

In dem vorliegenden Aufsatz wird versucht, nach einer kritischen Prüfung der vorgestellten Thesen, neue Argumente im Zusammenhang mit den Fragen der alb. rekonstruierten Urform und dessen allmählichen Evolutionsweg zu bringen. Auf Grund einer detaillierten Analyse auf der phonologischen und der morphologischen Ebene ist der Verfasser zu den folgenden Abschlüssen gekommen:

- 1) Die übrigen unteren Zahlwörter *një... dhjetë* «eins... zehn» des Albanischen sind altererbt, somit ein lat. Einfluss auf alb. *katër* unerwartet bleibt.
- 2) Ausgehend von dieser ausserlinguistischen Tatsache finden wir Güntert-These verlockend zu sein, der zufolge der Vokalismus /a/ der ersten Silbe auf

43) Shih ndër të tjerë O. Szemerényi, *vep. cit.*, f. 109, 153.

44) Në disa gjuhë indoevropiane bashkëtingëlloret sonante fundore bien edhe pas zanoreve të gjata: ind. e vj. *pitā* «baïa», *matā* «nënë», sll. e vj. *mati*, shih O. Szemerényi, *vep. cit.*, f. 89, 156.

die sogenannte Schwa secundum *_e zurückgeht. Dieser Auffassung zugunsten haben wir noch drei weitere lexikalische Einheiten zugebracht: alb. *thadér* «Axt mit zwei Schneiden, die eine als jede Axt, die andere als Meisel» aus idg. */k_es-d^hro-/; vergl. lat. *castrō, castrum*; ai. *śastrám* (< idg. */kes(/k_es) — tro-/); Alb. (i) *madh* «gross» /-s/ ai. **śpṛ̥ sñē* lat *magnus, maior*; alb. *shpat* «Steilhang, Böschung» aus idg. */p^ht-/ (andere Ablautstufen */pt-/, */pet-/, */pot-/ werden im gr. πέτης προπέτης πίπτω ai. *pátiati*, lat. *peto*, alb. -*pjetē* «oben», *shpend* «Vogel» usw. zugeführt). Die Untersuchung der Entwicklung des idg. *_e im Albanischen erfüllt damit die parallele Aufgabe des vorliegendes Beitrages, welche die Fachkundige erst von der Untertitel erlernen können.

3) Diese Lösung bietet dem Verfasser die Möglichkeit, die dazugehörende alb. Urform zu rekonstruieren: /katər/ < */qu_etuɔ̄r(-es)/, vergleichbar mit lat. *quattuor*, gr. homeri. πέντες a.s.l. /č t̪ȳr/ → poln. *czetery*, čech. *čtyři*.

4) Die diachronische Analyse der morphologischen Struktur /katər/ ermöglicht ihre typologische Gruppierung im Nominalsystem des Albanischen. Alb. *katər* wird demnach mit den altererbten Nominalstämmen auf Likuida /-r/: *motér* «Schwester», *vjehér(r)* «Schwiegervater», *dhéndér* «Bräutigam» verglichen. Die Vereinigung in diesem Form-Typus hat sich während der Zeitspanne nach der Akzentverschiebung auf die erste Silbe (/katər/) und nach dem Wegfall der Kasusendungen des Plurals bei dieser Einheit abgeschlossen.